

V E N D I M
Nr. 117, datë 28.8.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Petrit Plloçi,	Anëtar i “““
Tefta Zaka,	Anëtare e “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““

me sekretare Drita Panda, në datën 28.8.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.123 Akti që i përket:

KËRKUESE:PARTIA SOCIALDEMOKRATE E SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Engjëll Bejtaj dhe Mirash Martini.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. KOALICIONI “BASHKIMI PËR FITORE”, përfaqësuar nga Ferdinand Pone dhe Vladimir Mulaj, me prokurë.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i pjesshëm i vendimeve nr. 227 dhe nr. 228, datë 21.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si të papajtueshëm me nenin 64/2 të Kushtetutës.

Kërkuesi, për shfuqizimin pjesërisht si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve të sipërcituara, ka parashituar këto shkaqe kryesore:

- Nuk është zbatuar neni 64/2 i Kushtetutës, sepse numri i deputetëve të shpërndarë partive apo koalicioneve nga lista shumemërore nuk është bërë në raport të afërt me votat e vlefshme të fituara prej tyre. Nga kjo shpërndarje e padrejtë Partia Socialdemokrate ka marrë një deputet më pak.

- Nuk duhej zbatuar neni 66 i Kodit Zgjedhor, por duhej zbatuar drejtpërdrejt neni 64 i Kushtetutës, sepse ky është i vetmi nen që përcakton sistemin zgjedhor në Shqipëri. Zbatimi i drejtpërdrejtë i Kushtetutës jep si rezultat që Partia Socialdemokrate të përfitojë gjithsej 5 deputet në Kuvend.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimet nr.227 dhe nr.228, datë 21.8.2001, ka shpallur mandatet e fituara nga partitë për listat shumemërore, nga ku rezulton se Partia Socialdemokrate mbi bazën e 48.253 votave të fituara në raundin e parë të zgjedhjeve, të cilat llogariten në 3,645% të votave të vlefshme, ka përfituar 4 vende në Kuvend. Këto vendime janë nxjerrë, duke u bazuar në kriteret dhe rregullat që ka parashikuar neni 66 i Kodit Zgjedhor.

Kërkuesi pretendon se vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili nuk i ka caktuar 5 vende në Kuvend, nuk janë në përputhje me nenin 64 të Kushtetutës dhe për rrjedhojë dhënia e një

deputeti më shumë koalicionit “Bashkimi për Fitore”, nga lista shumemërore, ka cenuar drejtpërdrejt numrin e vendeve në parlament që Partia Socialdemokrate duhej të përfitonte.

Gjykata Kushtetuese çmon të domosdoshme të rritjes së njësive edhe njëherë qëndrimin tashmë të konsoliduar në vendimin nr.49, datë 2.6.2001 se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 64 të saj ka pranuar se sistemi i zgjedhjeve nuk është proporcional i pastër, por një kombinim i elementeve të sistemit mazhoritar me atë proporcional. Ky konkluzion i Gjykatës Kushtetuese që ka dalë mbi bazën e interpretimit kushtetutes që ajo ka kryer, qartëson dhe nuk krijon mundësinë e konfundimeve të ndryshme mbi llojin e sistemit zgjedhor të pranuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Pretendimi i kërkuarit për aplikimin e një formule të ndryshme nga ajo që parashikon neni 66 i Kodit Zgjedhor, jo vetëm që do të cenonte nga njëra anë interesat e partive apo koalicioneve të tjera të cilat përfitojnë nga listat shumemërore, por njëkohësisht do të binte ndesh dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të sipërcituar, e cila duke mos u shfuqizuar formulën si antikushtetuese, e ka bërë atë detyrues të zbatueshme për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Për përcaktimin e 40 mandateve plotësuese, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të shkelte Kushtetutën dhe ligjin nëse do të aplikonte formula të ndryshme nga ajo që ka parashikuar Kodi Zgjedhor. Mbi këtë bazë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke zbatuar kërkesat e nenit 66 të Kodit Zgjedhor, ka caktuar vendet për të gjitha partitë e koalicionet, nga ku ka rezultuar se kërkuarit i përkisnin vetëm 4 deputet.

Edhe pretendimi tjetër i kërkuarit për zbatimin drejtpërdrejtë të nenit 64 të Kushtetutës, duke iu referuar nenit 4 të saj pasi kjo do të sillte sipas tij përfitimin e 5 vendeve në Kuvend, nuk është i drejtë. Në Kushtetutën tonë është pranuar zbatimi i drejtpërdrejtë i dispozitave të saj, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Vetë Kushtetuta në nenin 68 të saj ka parashikuar se rregullat për caktimin e kandidatëve për deputetë, për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, si dhe kushtet e vlefshmërisë së zgjedhjeve rregullohen nga ligji për zgjedhjet. Pra ekziston një Kod Zgjedhor, i cili nuk mund të zbatohet. Përdorimi Kodi Zgjedhor, nëpërmjet nenit 66 të tij, ka parashikuar një mënyrë të ndarjes së mandateve shtesë, e cila kërkon detyruesisht një formulë ligjore dhe përse kohë kjo dispozitë nuk është konsideruar si antikushtetuese, atëherë zbatimi i drejtpërdrejtë i nenit 64 të Kushtetutës nuk mund të sjellë ndonjë ndarje të ndryshme të mandateve shtesë.

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.49, datë 2.6.2001 ku kërkuar ka qenë dhe Partia Socialdemokrate, i ka bërë një interpretim nenit 64 të Kushtetutës, duke konkluduar se nocioni raport sa më i afërt nuk është i njëjtë me nocionin e raportit saktësisht të barabartë që përpikët të zbatojë kërkuar. Sistemi i zgjedhjeve që ka pranuar Kushtetuta nuk mund të japë një raport saktësisht të barabartë midis numrit të deputetëve të çdo partie dhe votave të vlefshme të fituara prej tyre.

Nga sa parashtruar më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuarit për të shfuqizuar vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk janë të drejta dhe për rrjedhojë kërkesa e tij duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë duke u bazuar në nenet 131 e 132 të Kushtetutës, në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I :

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.